

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 17.03.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala, Ali Ismaili dhe Vildane Latifi.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Mirsad Qyqalla – Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Resul Makreshi - Drejtor për Teknologji Inovacion dhe Integritime Evropiane.

Të tjerë: Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 13.02.2026.
2. Propozim për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova.
3. Propozim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme.
4. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova.
5. Propozim për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbimet tjera me UNDP-në.
6. Propozim për ridestinimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve në Fushë-Kosovë.
7. Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në fshatin Graboc i Poshtëm.
8. Propozim për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale.
9. Propozim për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve.
10. Propozim për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërsimet e muajit janar 2026.
11. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025.
12. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 17, për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Statcionin e Policisë së Fushë-Kosovës.

13. Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale.
14. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028.
15. Propozim për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.
16. Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës’.
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe propozoi dy pika shtesë: Propozimin për zgjerimin e projektit për vendosjen e pompave termike në shkollat e komunës dhe Propozimin për caktimin e anëtarëve të komunës tonë në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2025-2029. Po ashtu sqaroi se te pika për emërtimin e rrugëve do të jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Hap diskutimin.

Filloreta Musaj: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem me rendin e ditës dhe dy pikat shtesë të [elaboruara tani nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës](#).

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi që pikë shtesë të jetë: caktimi i lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir. Edhe te propozimi për vendosjen e pompave termike në shkollat e komunës, nuk përfshihet shkolla e fshatit Lismir, ka një tendencë që kjo shkollë të mbyllet, po synohet që të ndërtohet një shkollë e re në lagjen e Nakaradës, ku do të vijjnë edhe nxënësit nga fshati Lismir, kjo punë dhe qasje e pushtetit aktual nuk është në rregull.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë jam kundër ndërtimit të Çerdhes së Fëmijëve në rrugën ‘Fehmi Lladrovci’, në lagjen e Nakaradës, në lokacionin e propozuar në mes të varrezave, edhe propozimi për Çerdhe të Fëmijëve në fshatin Graboc i Poshtëm ka shumë mangësi, duhet të plotësohet nga Drejtoria e Arsimit. Qëndrimin tonë do ta japim kur të vijmë te pikat e caktuara.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për pikat shtesë unë në parim jam kundër, sepse ju vetë i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, për katër vite, keni qenë kundër pranimi të pikave shtesë për shqyrtim. Lidhur me pikën shtesë mos ndërhyjni znj. Vildane Latifi, sepse nuk keni njohuri për këtë punë, nuk i dini rrethanat e projekteve kapitale të miratuara vitin e kaluar.

Vildane Latifi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Akuza e juaj është e pa drejtë, tani ne e kemi buxhetin, e kemi analizuar dhe e dijmë, po ashtu edhe e kemi të qartë, si duhet të veprojmë, [andaj ju nuk duhet të paragjykoni](#).

Ali Ismaili: Kodi buxhetor i projektit nuk mund të ndryshohet, nuk janë analizuar as cmimet e pompave termike në tregun e lirë. Në kodin buxhetor Nr. 20886 janë gjysëm milioni euro, andaj nuk është në rregull ta ngrisni zërin, kur Drejtori për Arsim nuk është prezentë. Ideja është se pikat shtesë, nëse nuk janë urgjente nuk ka nevojë të shqyrtohen fare

Vildane Latifi: Ju lutem mos paragjykoni, unë pajtohem me rendin e ditës dhe dy pikat shtesë.

Laureat Gojnovci: Ajo që e theksoi kolegu z. Ali Ismaili është e vërtetë, pika e Asociacionit ka ardhur në Zyrën e Kryetarit të Komunës me datën 11 shkurt, kemi mundur ta shqyrtojmë dhe aprovojmë në muajin e kaluar, tani jemi një muaj e gjysëm prapa. Për shkollën ju e keni shfuqizuar vendimin e muajit shtator, për caktimin e lokacionit për shkollën e fshatit Lismir.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Asnjë vendim nuk është anuluar për shkollën, është shfuqizuar një vendim i vlerësuar, se është i kundërligjshëm nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Tani e qesim në votim pikën shtesë: Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës. U votua me: katër vota ‘për’, tre votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Tani e qesim në votim pikën shtesë: Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

U votua me: katër vota ‘për’, dy votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë pjesëmarrës në votim nga shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Tani e qesim në votim: Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir.

U votua me: një votë ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej një anëtarë pjesëmarrës në votim nga shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir, nuk kalon në mungesë të votave.

Tani e qesim në rendin e ditës me dy pikat shtesë: Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës dhe Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

U votua me: katër vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej katër anëtarë pjesëmarrës në votim nga shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovuan për shqyrtim: Rendin e Ditës me dy pikat shtesë: Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës dhe Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 13.02.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Aprovohet 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 13.02.2026'. Hap diskutimin.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, pajtohem që të aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 13.02.2026'. Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 13.02.2026'.

U votua me: pesë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se aprovohet me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 13.02.2026'.

Pika e dytë (2) - Propozim për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: I nderuari Drejtor z. Izja Mjeku, fjala për ju, lidhur me Komisionin Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale i Fushë-Kosova.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Sikur e dijmë tani është marrë vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 20.02.2026, është marrë vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike, tani ne duhet ta caktojmë Komisionin Komunal të Aksionarëve, me dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe një nga Kryetari i Komunës, i cili do ta zgjedh Bordin e Drejtorëve dhe Kryeshefin Ekzekutiv. Këtu një përfaqësues e jep Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa përfaqësuesin e dytë subjektet tjera politike.

Filloreta Musaj: Ne emrin e përfaqësuesit tonë e japim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, andaj pajtohem që ky propozim të procedohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Këtu ka një tendencë për ndryshim, propozohet një përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, përfaqësuesi i dytë nga Kuvendi, është dashur të ishte nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e jo nga subjektet tjera politike të Kuvendit të Komunës, ashtu sikur e keni paraqitur në propozim. Ligji thotë duhet të jenë dy anëtarë të Kuvendit të Komunës, praktika ka qenë që të jenë dy përfaqësues nga dy subjektet me të mëdha të Kuvendit të Komunës.

Dardane Sogojeva Shala: Unë dua të ndërlidhem me diskutimin e z. Laureat Gojnovci, pse të mos jetë një përfaqësues në këtë Komision nga Partia Demokratike e Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Me ligj në Ndërmarrje Publike Lokale, duhet të jenë dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, për këtë punë vendimin përfundimtarë e merr Kuvendi i Komunës.

Ali Ismaili: Tani mirë po thuani ju, për këtë punë vendos Kuvendi i Komunës, pse të mos jetë anëtarë këtu edhe dikush nga subjektet e vogla politike në Kuvendin e Komunës.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera lidhur me përfaqësimin në këtë Komision, me propozime nga secili subjekt politikë, pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës theksoi se duhet ta qesim në votim 'Propozimin për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Ali Ismaili: Nëse është shënuar gabim propozimi, nuk e cakton emërimin, sepse ligji thotë duhet të jenë dy anëtarë të Kuvendit të Komunës, kërkesa ime është që këta persona të jenë ekspertë të fushës, të njohin punën e Ndërmarrjes Publike Lokale e cila është në fillimin e punës së saj.

Laureat Gojnovci: Kërkoi që në këtë Komision të përfaqësohet edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, por ky propozim i mori vetëm dy vota.

Dardane Sogojeva Shala: Po ashtu edhe unë kërkoi që në këtë Komision të përfaqësohet, Partia Demokratike e Kosovës, por ky propozim i mori vetëm dy vota.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës, sipas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit'.

U votua me: katër vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim, nga shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të pjesëmarrësve në votim Komiteti për Politikë dhe Financa e procedoi për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova'

Pika e tretë (3) - Propozim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e ftojme Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Izja Mjeku, ta paraqes 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme'.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis, në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Drejtorin e Pronës, në konsultim paraprak edhe me Kryetarin e Komunës, propozon caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në fshatin Miradi e Poshtme, me sipërfaqe S=22808m² dhe këtij propozimi i bashkangjitet edhe materiali në vazhdim. Arsyeja është sepse nuk kemi gjetur pronë komunale në zonën e qytetit të Fushë-Kosovës.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim dhe procedim për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme'.

Laureat Gojnovci: Tani Kryesues i Kuvendit, këtu qëllimi është që dokumentacioni që e shqyrtojmë të jetë ligjor, në përputhje me Hartën Zonale të Komunës, ajo zonë është për rekreacion dhe turizëm. Ne e kemi në fuqi një Hartë Zonale të Komunës, të cilën duhet ta respektojmë dhe zbatojmë.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Këtu interesi i komunës, është që të fillojmë me punën, të nisë funksionalizimi i Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, e jo të paraqesim pengesa të pa arsyeshme.

Laureat Gojnovci: Këtë punë e dinë në Drejtorinë e Planifikimit Urban, andaj kjo punë nuk lejohet të bëhet në këtë zonë, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinorë.

Dardane Sogojeva Shala: Për këtë punë, përfaqësuesit e komunës, është dashur ta mbajnë një diskutim publik edhe me banorët e fshatit Miradi e Poshtme, sepse këtu kemi të bëjmë me pronë të fshatit.

Ali Ismaili: Ju vetë Kryesues i Kuvendit në të kaluarën nuk keni lejuar punë të tilla, e dini mirë rastin e Xhamisë në Fushë-Kosovë, që nuk është lejuar sipas Hartës Zonale të Komunës, është konsideruar nga ana e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, si vendim i kundërligjshëm, unë do ta votoi këtë lokacion në Miradi të Poshtme. Në të kaluarën janë votuar edhe shkollat Aneksin një, dy dhe tre, madje pushtetarët thonin: se për shkolla ne nuk e kemi problem shkojmë edhe në burg, ju vetë e keni penguar punën e varrezave në fshatin Miradi e Epërme, ku Etniku dhe Ekrem Berjani e kanë refuzuar, duke mos e pranuar debatin e zhvilluar jashtë komunës, ju këtë punë e dini shumë mirë. Për këto punë duhet të zhvillohet debate publik në komunë, ose në fshat i organizuar nga komuna.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Rasti ka qenë ndryshe, sepse në fshatin Miradi e Epërme, janë marrë 26 hektarë, kanë mbetur vetëm 2 hektarë për nevoja të fshatit, këtë punë e ka bërë Ish/Kryetari z. Burim Berisha, pa asnjë debat publik, ajo që po pretendon z. Laureat Gojnovci nuk është e njëjtë, sepse kompensimi i tokave në fshatin tonë, ju ka dhënë banorëve nga fshatrat tjera për kompensim për tokat e marra për rregullimin e shtratit të lumit Sitnica. Nëse vendimi jonë është gabim kthehet në rishqyrtim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Laureat Gojnovci: Prona ka pengesa ligjore, është e destinuar për rekreacion dhe turizëm, tani ju vetë jeni në kontradiktë me vendimin e shkollës për fshatin Lismir, të cilin e keni shfuqizuar.

Dardane Sogojeva Shala: Këtu duhet të respektojmë, atë që e thotë ligji dhe dokumentet e planifikimit hapësinorë në fuqi.

Ali Ismaili: Unë do ta mbështes këtë propozim, sepse kemi të bëjmë me Ndërmarrjen Publike Lokale, të cilën të gjithë e presim, që të jetë funksionale sa më shpejtë dhe të fillon punën në teren, por megjithatë, vlerësimin përfundimtarë për këtë vendim e jep Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Unë nga muaji dhjetor 2025, nuk po shoh ndonjë efikasitet në punë esenciale, me përjashtim të promovimit dhe takimeve solemne, që pajtohem se e kanë një peshë, por duhet punë më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mirë, po e hedhim në votim këtë 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme. U votua me: pesë vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme' dhe mori:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme'.

Pika e katërt (4) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale – Fushë-Kosova.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftojme drejtorin Izja Mjeku ta paraqes materialin në emër të Kryetarit të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Sikur po e shihni ky propozim është nga Kryetari i Komunës, tani unë po e lexoi propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 300,000.00€, të cilat do të merren nga rritja e të hyrave vetanake dhe bartja e tyre për shpenzime në vitin 2026, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. 200, program Infrastruktura Publike Nr. 18162. Strukturën dhe bazamenti e ndërtimit të projektit do ta bëj ekipi profesional i arkitektëve dhe inxhinierëve të komunës.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim dhe procedim për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozim për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova'.

Laureat Gojnovci: Sipas meje kjo ndërmarrje nuk ka filluar mirë, ju nuk jeni kompetentë të kërkonit lejimin e mjeteve financiare nga Kuvendi i Komunës.

Dardane Sogojeva Shala: Edhe unë pajtohem, që sqarimet lidhur me mjetet financiare, duhet të jepen nga Kryetari i Komunës ose Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Ali Ismaili: Shpenzimi i këtyre mjeteve financiare këtu, por edhe te Drejtoria e Arsimit për pompa termike, mund të kualifikohet nga Auditimi i jashtëm si keqëklasifikim i shpenzimeve, andaj këtu situato kërkojnë një sqarim të mirëfilltë profesional, ndarja e këtyre mjeteve financiare nga subvencionet, i zvogëlon mjetet financiare për pacientët, personat me sëmundje të rënda, unë kam besuar se do të punoni pak me ndryshe, por këtu nuk po vërehet asnjë ndryshim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Buxheti i Kosovës është miratuar, me ndryshime, andaj ne duhet ta bëjmë këtë ridestitim nga të hyrat vetjake, për shpenzim në të mirën e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova. Po e hedhim ne votim tani 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova'.

U votua me: katër vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova'.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në'. Hap diskutimin.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim dhe procedim për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në'.

Laureat Gojnovci: Ky propozim duhet të bëhet pasi që të funksionalizohet ndërmarrja, kush menaxhon, nuk ka asnjë specifikacion, kush i vlerëson ato pajisje për punë UNDP-ja, komuna apo ndërmarrja që nuk është funksionalizuar ende.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: UNDP-ja edhe Komuna e bëjnë marrëveshjen edhe për shërbime tjera, edhe të ndërmarrjes, sepse kjo punë është bashkëfinancim

Ali Ismaili: Ne këtu nuk e kemi asnjë informacion për marrëveshjen me UNDP-në.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e hedhim në votim 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në'.

U votua me: pesë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbimet tjera me UNDP-në'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ridestininimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroj se pika e gjashtë e rendit të ditës tërhiqet nga shqyrtimi me 'Kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa e tërheqë nga rendi i ditës 'Propozimin për ridestininimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes së Fëmijëve në Fushë-Kosovë'.

Pika e shtatë (7) - Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në fshatin Graboc i Poshtëm.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në fshatin Graboc i Poshtëm'. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Ridestinimi i Çerdhes së Fëmijëve, këtu kërkohet pa material, mungon arsyetimi, mungojnë të dhënat për pronën, unë ju siguroj juve, se kjo punë nuk është tërheqë për arsye teknike.

Dardane Sogojeva Shala: Unë jam kundër Çerdhes së Fëmijëve, në afërsi të varrezave, e arsyeshme është që ajo zonë të zgjerohet për varreza. Lidhur me propozimin për fshatin Graboc i Poshtëm, a mundet me na sqaruar Drejtori për Arsim, a është pronë e komunës, apo pronë private, me sa e di unë prona është private dhe nevoja është më e madhe për Ambulancë të Mjekësisë Familjare, se sa për Çerdhe të Fëmijëve.

Rrahim Sogojeva: Ka pasur diskutime që ky objekt të përdoret edhe si Shtëpi për të pame, mirëpo tani kërkohet ridestinimi për Çerdhe të Fëmijëve dhe ne e përkrahim

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e hedhim në votim tani 'Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në objekt për Çerdhe të Fëmijëve në fshatin Graboc i Poshtëm'. U votua me: katër vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në objekt për Çerdhe të Fëmijëve në fshatin Graboc i Poshtëm' me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në fshatin Graboc i Poshtëm'.

Pika e tetë (8) - Propozim për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale'. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për lirim nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale'.

Pika e nëntë (9) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë po shkojmë direkt te emrat të cilat unë do t'i lexoi tani është: Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban - Kryesues i Komisionit, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike dhe sqaroi se në këtë Komision duhet të jetë edhe Kryesues i Kuvendit të Komunës. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve', me sugjerimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, që pjesë e këtij Komisioni të jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve', me sugjerimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, që pjesë e këtij Komisioni të jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve', me sugjerimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, që pjesë e këtij Komisioni të jetë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për shqyrtimin e Raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani unë e kam një sqarim për koleget asambleistë, materiali që ju ka ardhur janë të dhënat personale të disa përfituesëve dhe ju lutem, të mos i shpërndani këto të dhëna, sepse mund të penalizohen me Ligjin e Privatësisë. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026'.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Është materiali i herës së kaluar nevojitet për performancë, janë statistika të vitit të kaluar dhe nevojitet t'i keni për analiza të punës një vjeçarë. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Raportin e Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të 'Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025'.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 17, për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim në rishqyrtim këtë material, tani Kryetari i Komunës në përputhje me nenin 40, paragrafi 40.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 27, të Statutit të Komunës me Nr. 98, të datës 17.08.2012, për të zgjidhur çështjen e mbetur pezull nga periodha e kaluar, duke rezervuar të drejtën për marrjen e një pëlqim të përkohëshëm të këtij objekti brenda vitit 2026, me qenë se ambulanta është ndërtuar në pronën e mengjuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit para më shumë se dhjetë viteve, për delegimin e kompetencave për Kryetarin e Komunës, për marrjen e pëlqimit nga Agjensia Kosovare e Privatizimit për shfrytëzim të kësaj prone.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për marrjen e pëlqimit nga Agjensia Kosovare e Privatizimit për shfrytëzim të kësaj prone, për nevojat e Policisë së Kosovës për Zyre Sektoriale'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Rishqyrtimin e vendimit Nr. 17, të datës 28.01.2026 për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Rishqyrtimit të vendimit Nr. 17, të datës 28.01.2026 për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë-Kosovës'.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroj se rritet numri i anëtarëve, në mënyrë që të përfshihen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në Grupin Punues të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha: tre anëtarë janë nga Lëvizja Vetëvendosje, tre anëtarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe dy anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës. Në Grupin Punues të Rregullores për Subvencione: një anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës, po ashtu shtohet edhe një nga subjektet e tjera politike. Në Grupin Punues të Rregullores për Këshillat e Lagjeve Urbane dhe Fshatrave, shtohet një anëtar nga subjektet e tjera politike.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale', me plotësime si vijon: Në Grupin Punues të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha, 3 anëtarë nga Lëvizja Vetëvendosje, 3 anëtarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, 2 anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës, në Grupin Punues të Rregullores për subvencione një anëtarë i Partisë Demokratike të Kosovës dhe një nga subjektet tjera politike dhe në Rregulloren për Këshillat e lagjeve urbane dhe fshatrave, edhe një anëtarë nga subjektet tjera politike'.

U votua me: shtatë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale', me plotësime si vijon: Në Grupin Punues të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha, 3 anëtarë nga Lëvizja Vetëvendosje, 3 anëtarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, 2 anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës, në Grupin Punues të Rregullores për subvencione një anëtarë i Partisë Demokratike të Kosovës dhe një nga subjektet tjera politike dhe në Rregulloren për Këshillat e lagjeve urbane dhe fshatrave, edhe një anëtarë nga subjektet tjera politike', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale', me plotësime si vijon: Në Grupin Punues të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha, 3 anëtarë nga Lëvizja Vetëvendosje, 3 anëtarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, 2 anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës, në Grupin Punues të Rregullores për subvencione një anëtarë i Partisë Demokratike të Kosovës dhe një nga subjektet tjera politike dhe në Rregulloren për Këshillat e lagjeve urbane dhe fshatrave, edhe një anëtarë nga subjektet tjera politike.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim në parim për diskutim publik 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028'.

U votua me: gjashtë vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim në shqyrtimin e parë në Kuvendin e Komunës të 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028'.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo- arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës'. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimin për shqyrtimin e vendosjes së pompave termike, në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: katër vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e vendosjes së pompave termike, në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e vendosjes së pompave termike, në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për caktimin e përfaqësuesve të Komunës së Fushë-Kosovës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani duhet ta caktojmë tre përfaqësues nga subjektet politike nga Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës'.

U votua me: katër vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës'.


Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Të Ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim. Nëse jo atëherë falënderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:55 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani

